

DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:

“Rikonstruksioni I Godines se Poliklinikes, Berat”



Berat, 2023

Spitali Berat, kërkon të realizojë studim- projektimin për objektin: “Rikonstruksioni I Godines se Poliklinikes, Berat”

1. TË DHËNA DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME



Objekti “ **Rikonstruksioni I Godines se Poliklinikes, Berat**” ka një sipërfaqe të truallit prej rreth 1200 m² dhe ndodhet në qendren e Qytetit te Beratit. Rikonstruksioni I kesaj godine eshte shume I rendesishem pasi eshte tejet e amortizuar.


Kjo godine eshte ndertuar rreth viteve 70, dhe ka pasur ndonje nderhyrje te vogel gjate viteve. Godina eshte e ndare ne 3 kate. Siperfaqet e kateve jane si me poshte.



SIP. KATI PERDHE = 582M²


SIP. KATI PERDHE = 548M²

SIP. KATI I DYTE = 574M²

SIP. KATI TARRACA= 104M²







2. KËRKESA TË PROJEKTIT

Referencat e vendosura në këtë detyrë projektimi synojnë hartimin e një projekti i cili përmbush objektivat si më poshtë:

- Organizimin e godines ku te kete, ambjente Sherbimi, ambjente magazinimi per nevoja te spitalit si dhe ambjente per administraten.
- Integrimin e godines me arkitekturen perreth dhe rikonceptimin e hapesires se jashtme.
- Organizimin e hapesirave rekreative, gjelberimit,
- Të sigurojë impaktin mjedisor.
- Te siguroje dhe vend parkime dhe zonen e sherbimit
- Fasada ti pershtatet pjeses Historike te qytetit.

2.1 Skema funksionale

Projekti/skema e funksionimit të godines duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Zyra pritje, reception
- Dhoma per mjeket, infermieret
- Dhoma Analizash,
- Dhoma sherbimi
- Dhoma Shtrimi Pacientesh

- Ambiente Magazinimi

Te merret ne konsiderate qe materialet qe do te perzgjidhen nga projektuesi te jene te cilesise se larte dhe Konform normave te Be, si dhe KTZ ne fuqi.

2.2 Ndrichimi

Ndrichimi i godines duhet të parashikohet të bëhet teresisht i ri e sipas kapaciteteve te ndertimeve te reja dhe duke patur parasysht edhe rezervat ne lidhje me perspektiven e zhvillimit te godines

Të respektohen normat Europiane të performancës së ndriçimit EN 13201 :

Ndrichuesit të jenë me kontroll smart në mënyrë, që të rregullohet intensiteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të Godines

Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1;2014. Të përcaktohet performanca e ndriçimit sipas përdoruesve.

2.3 Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut

Gjate hartimit të projekt - zbatimit projektuesi duhet të vlerësojë nëse gjatë rehabilitimit është e nevojshme ndërhyrja në kanalizimet ekzistuese, me riparimet e rrjetit ose me krijimin e një rrjeti të ri paralelisht me atë ekzistues.

2.4 Ujësjiellësi

Në bashkëpunim me Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. do të saktësohet gjendja e ujësjiellësit egzistues, projektet që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura më parë në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin egzistues të ujësjiellësit.

2.5 Gjelibërimit

Të parashikohet vendosja e gjelibërimit të lartë (pemëve dekorative) dhe mbjellje me bar ne hapësira te caktuara

2.6 Sistemi I ngrohjes

Te parashikohet vendosja e nje sistemi ngrohje – ftohje qendror, dhe me komandim te vecante per secilen njesi

3.Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës të cilat duhet të jenë sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

4. Standartet

4.1 Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuar). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

4.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:

- Pozicionimi në hartat;
- Foto e situatës ekzistuese;
- Vrojtimi gjeometrik dhe arkitektonik i situatës ekzistuese
- Përshkrimi i situatës aktuale;

5. Realizimi i Projektit

Realizimi i projektit do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave te referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit: Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,word etj.)

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

- a. Analiza e aksesibilitetit dhe zonimit, referuar Planit të PDyV-s
- b. Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)
- c. Vizatimet teknike, planimetri të përgjithshme, prerje tip të sheshit dhe rrugëve, në një shkallë të lexueshme;
- d. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
- e. Preventiv paraprak

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,word etj.)

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt-idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë:

Raport teknik;

Preventivin e punimeve referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”; ndryshuar me VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ndryshuar me VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.

Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;

Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;

Rilevimi;

Studimi gjeologjik;

Studimin sizmik

Vlerësimin e ndikimit ne mjedis

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,word etj.)

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për

leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Durrës

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: “Rindertimi i Objekteve Hoteliere dhe Rikonceptimi i Hapesirave të Jashtme - Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme, Durrës”. duhet të përmbajë:

1. Raporti Teknik
Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar. Raporti të sigurojë të dhëna të sakta, bazuar në testet / vlerësimet ekzistuese, llogaritjet e bëra, masat inxhinierike që parashikohen të merren, etj. Në raportin teknik do të përfshihet raport arkitektonik, raport strukturor, elektrik, hidro etj., si dhe studimet mbështetëse (vlerësimet topografike, gjeologjik dhe materiale, , etj.).
Llogaritjet statike të strukturave;
2. Hartimi i relievit topografik (koordinata lokale, kuota absolute)
3. Pasqyrimi në projekt i azhurnimeve të rrjetit ekzistues të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe të zeza, rrjetit të elektrikut dhe interenet – telefonisë;
4. Raport gjeologjik;
5. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve
6. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut;
7. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza;
8. Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vendosjen e hidrantëve zjarrfikës mbështetur në normat në fuqi;
9. Projektin e ndriçimit, skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse;
10. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret. Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:
 - Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
 - Metoda e vendosjes;
 - Cilësia e kërkuar;
 - Format e miratuara;
 - Ngjyra e rekomanduar;
 - Skica, vizatime ose foto
11. Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknik të çmimeve në fuqi;
12. Grafikonin e punimeve të ndërtimit;
13. Planin organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikonin e punimeve;
14. Planin I piketimit të objektit
15. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
16. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakti i regjistrit tregtar.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg., word, excel.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ndryshuar me VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me këtë projekt.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Administrata
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.
- Në projekt të parashikohet mundësia e krijimit të fasiliteteteve për PAK.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar:

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Investitorin .Stafi, që kërkohet duhet të përfshijë:

- Arkitekt
- Inxhinier ndertimi
- Inxhinier hidroteknik;
- Inxhinier gjeolog;
- Inxhinier topograf;
- Inxhinier elektrik;
- Inxhinier mjedisi;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale, dhe në 3 (tre) CD.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Llogaritjet statike të strukturave .
- Raportin teknik.
- Preventivi i plotë i kushtimit të veprës.
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

- Horografia

- Topografinë e gjendjes ekzistuese, në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme në Shk. 1:500 ose 1:1000;
- Planimetria e prishjeve në shkallë 1:500;
- Planimetrite e gjendjes ekzistuese te godinave ne shkalle. 1:100
- Planimetrite e ridimensionimit te ri ;
- Planimetrite e projektit elektrik;
- Planimetria e ndriçimit;
- Planimetrite e projektit mekanik;
- Planimetri dhe detaje te konstruksionit;
- Detaje arkitekture;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Duke u nisur nga Siperfaqja e Godines qe do te Rikonstruktohet, dhe nga Kerkesat e detyres se Projektimit, Nga nje llogaritje Paraprake eshte menduar se Investimi Arrin ne Vleren **180,000,000 (njeqind e tetedhjetë million) Leke**. Per kete vlere te behen dhe llogaritjet Per Hartimin e Projekt Zbatimit sipas fazave te Percaktuara ne **VKM 354 datë 11.05.2016**

Punoi:
Ing._____

Miratoi:
Spitali Berat
Drejtor
Zj.Anila Kala